



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) - Rahovec, e mbajtur më 15.3.2024, me fillim në orën 15:00. Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komunës, z. **Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes, kuorumi ekziston. **Kryetari:** Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSBS-së, drejtoret e drejtive, nënkyryetarin, komandantin e stacionit të polisë në Rahovec, z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e FSK-së, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, të OSBE-së, të KFOR-it, të UEN-it, të LMT-së, zyrtarët komunalë dhe mediet. Është mbledhja e dytë e rregullt për vitin 2024. Siç e dini, ndërmjet dy mbledhjeve kemi mbajtur një mbledhje urgjente të KKSBS-së. Për këtë mbledhje të rregullt, propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria në trafik;
 - Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Vetëdijesimi i nxënësve përrrezikun nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera nga lufta;
 - Trotuaret dhe shenjat sinjalizuese në territorin e Komunës;
 - Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike, konkretisht trotuareve;
3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;
4. Sensibilizimi i qytetarëve përrëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndëretnik, multikulturor dhe ndërfetar;
5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
7. Të ndryshme.

Kryetari: Nëse ka dikush ndonjë koment rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është "për"?... A ka votë kundër?... Faleminderit, pra mund të fillojmë takimin me këtë rend dite.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryetari: A ka dikush vërejtje apo plotësime rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e hedhim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet procesverbalı.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:

Kryetari: Në këtë pikë janë edhe nënpikat që janë në interes përrtunjshëm për t'u trajtuar në këtë takim. Është e vërtetë që ka pasur zhvillime dhe aktivitete nga institucionet, nga administrata komunale dhe nga KKSBS-ja përmes mbledhjes urgjente, që si qëllim kryesor ka qenë përmirësimi i gjendjes së sigurisë në komunën tonë. Fakti që kanë ndodhur disa veprime, të cilat te ne e kanë krijuar një gjendje jo të lehtë emocionale përrfshirë familjet e prekura. Dëshiroj ta theksoj faktin që ne kemi organe ligjore me detyra dhe përgjegjësi në fushëveprimtari të caktuara dhe të gjitha

këto na japid të drejtën të themi që siguria në komunën tonë, pavarësisht veprimeve të dëmshme të keqbërësve, është e qetë dhe stabile. Për këtë temë do të flasë më shumë kapiteni i PK-së, Fazli Morina.

Fazli Morina: I nderuar kryetar, pjesëtarë të FSK-së, LMT-së, Zyra e UNMIK-ut në Pejë, anëtarë të KKSBB-së! Prej takimit të fundit është një kohë e shkurtër, përkundër kësaj, ka pasur raste dhe aktivitete. Pavarësisht rasteve të fundit, ne vlerësojmë që situata e sigurisë në komunën tonë dhe në zonën e përgjegjësisë është e qetë dhe stabile. Jemi në vazhdim të implementimit të 6 planeve operative dhe 12 planeve të veprimit. Gjatë kësaj periudhe, në stacion, janë iniciuar 45 vepra penale, nga këto mund t'i veçojmë: 1 rast grabitje, 1 rast vrasje në tentativë – armëmbajtje pa leje, lëndime të lehta - 3 raste, vjedhje - 3 raste, vjedhje të rënda - 5 raste, dhunë në familje - 3 raste, posedim i narkotikëve - 3 raste dhe armëmbajtje pa leje janë dy raste. 12 persona janë të arrestuar, në mbajtje kanë qenë 7 persona. Lidhur me të gjitha këto raste, në bashkëpunim me hetimet rajonale në Gjakovë, kanë vazhduar veprimet rrëth ndriçimit të rasteve të fundit të vjedhjeve. Rasti i parë në Ratkoc, 23.2.2024, i cili është hetuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë, në bashkëpunim me stacionin në Rahovec dhe më datë 5.3.2024 është arritur që të arrestohen personat e dyshimtë dhe një është akoma në kërkim. Rasti është duke vazhduar dhe jemi në pritje të prokurorisë për ta ndriçuar komplet rastin. Rasti i dytë në Krushë të Madhe, 24.2.2024, që është cilësuar vrasje në tentativë dhe është duke hetuar nga hetimet rajonale në Gjakovë, në bashkëpunim me stacionin e polisë në Rahovec dhe deri më tanë, të arrestuar janë 4 persona, 2 të dyshuar dhe janë konfiskuar 4 armë zjarri dhe një sasi e municionit. Rasti i tretë është i cilësuar grabitje në tentativë dhe publikisht e falënderoj kryetarin që ka gjetur kohë dhe ka qenë i përkushtuar deri në orët e vona të natës, ka marrë pjesë së bashku me ne. Në një shtëpi është dëmtuar vetëm xhami i derës hyrëse dhe në dy shtëpi të tjera nuk ka pasur thyerje dhe as vjedhje. Gjatë angazhimit dhe veprimeve tona është gjetur vetëm një gëzhojë ku pretendohet që është tentuar të zhvillohet grabitja. Pjesa tjetër e aktiviteteve: Janë 40 urdhëresa të gjykatave, 8 asistime në institucionë të ndryshme. Sa i përket komunikacionit rrugor, jemi në vazhdimi të implementimit të sigurisë në trafik. Janë shënuar gjithsej 903 gjoba për kundërvajtje në komunikacion, 375 për tejkalim të shpejtësisë, 2 për gara të shpejtësisë, 35 pa patent-shofer, 67 gjoba për parking ilegal dhe 12 gjoba për përdorim të telefonit gjatë vozitjes. Sa u përket aksidenteve, kanë qenë gjithsej 9 dhe përfat të mirë, aksidente me fatalitet nuk ka. Te siguria në shkolla jemi duke vazhduar njëjtë me të gjitha planet operative. Kanë qenë dy raste të hapura, njëri është keqërdorim i detyrës zyrtare.

Lulzim Krasniqi: Përshëndetje, kryetar! Dëshiroj të ndërlidhem me pikën siguria në trafik. Rreth rrugës "Sadedin Hajda", afër shkollës, është rrezik i madh sepse asfalti është pa mur mbrojtës dhe rrezik për komunikacion. Gjithashtu rruga tek autoshkolla "Andi" e këndeje, është në rrezik dhe mund ta pësojë dikush me makinë. Pyetje rrëth rrugës së UÇK-së që janë ndërmarrë punimet për shtrirjen e shiritit të tretë të asfaltit, ndërsa një rrugë që, tashmë kërkesa është e njohur për ju, është gjendja e rrugës "Bereddin Shehu".

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSBB-së. Në rrugën "Sadedin Hajda", Luli flet për një mur mbrojtës që është shembur rruga. Pjesa ku është ajo është pronë private dhe nëse do të ketë kërkesë nga pronari me bashkëparticipim, atëherë do të veprojmë. Në rrugën "Dëshmorët e Pashtrikut" po ashtu është pronë private, por sidoqoftë këto informata i kemi të njohura nëse hasim në mirëkuptim. Sa i përket rrugës së UÇK-së, ne jemi në fazën që aty punimet do të fillojnë shumë shpejt.

Kryetari: Faleminderit! I kemi edhe dy nënpika për të cilat nuk u fol hiç. Trotuaret dhe shenjat sinjalizuese në territorin e Komunës dhe identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike, konkretisht trotuareve.

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryetar! Sa i përket sinjalizimit vertikal dhe horizontal, ne veç jemi duke punuar, duke bashkëpunuar me policinë dhe aktorët e tjera. Sa u përket hapësirave publike, në bashkëpunim me inspektoratin, i shqyrtojmë kërkesat për shfrytëzime të hapësirave publike.

Kryetari: Faleminderit, Përparim! Te çështja e shembjes së rrugëve. Në qoftë se është pronë private, ai që pretendon ta hapë një bodrum, duket ta ketë gjithashtu parasysh që nuk ka të drejtë të veprojë ashtu siç veprohet

në këto raste. Besoj që Komuna e Rahovecit ka inspektorë dhe duhet t'u tërhiqet vëmendja atyre që veprojnë kështu. Inspektorët duhet t'i shpeshtojnë vizitat në terrene. Te lirimi i hapësirave publike: siç jeni në dijeni që në qytet ka mjaft punishte, të cilat kanë shkaktuar kufizime në parkingje. Kjo nuk do të thotë që jeta e këmbësorëve të rrrezikohet dhe veturat të parkohen në trotuare. Më pëlqeu një koment në rrjete sociale: "Pse nuk i parkojnë te stacioni i autobusëve?" Është një hapësirë 2 ha, por kuptohet që duhet pak të ecim dhe të ecim është mirë, sepse kalitja fizike është veti patriotike. Kërkoi nga komandanti që policia të jetë më aktive në lirimin e hapësirave publike, sidomos trotuareve. Sa u përket plaçkitjeve të fundit, ndriçimi i këtyre rasteve është mundësi e mirë që nga të njëjtët mos t'ë përsëriten rastet e tjera, që mund t'ë janë me pasoja më të mëdha. Policia ka qenë shumë aktive dhe besoj që është duke i kryer punët e veta, në mënyrë që aktorët ta marrin dënimin e merituar.

Fazli Morina: Faleminderit, kryetar! Pavarësisht që më parë e cekëm që gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile, për shkak të rasteve të fundit që kanë ndodhur, mbi të gjitha jemi në rrugë të duhur drejt ndriçimit të këtyre rasteve. Sa i përket trafikut, sot personalisht jam angazhuar me inspektimet të patrullave dhe zyrtarëve policorë në terren. Në krahasim me qytetet e tjera, jemi në nivelin më të mirë të mundshëm. Konkrektisht, nuk jemi në nivelin e duhur në vendosjen e shenjave horizontale dhe vertikale në qytet. Problematika kryesore është në qendër të qytetit dhe shënjimi nuk është në formën më të mirë të duhur. Shkaktarë janë të gjitha lokalet që janë aty, nuk kam asgjë kundër veprimtarisë së tyre që e zhvillojnë, por për shkak të mungesës së parkingut kjo çështje nuk është e rregulluar aty, sepse nuk është i identifikuar qartë vendparkingu. Pjesa poshtë e qytetit është me bagera, lugë të bagerave, motorë, si dhe lokalet afariste që paletat e tyre i vendosin në trotuar etj.. dhe gjysma e tyre janë në trotuar, sidomos në pjesën e poshtme. Drejtorinë e Inspeksionit jemi të gatshëm ta mbështesim dhe të punojnë së bashku. Është kërkesë drejtpërdrejt nga unë që t'ë paktën gjendjen me shënjim ta koordinojmë pak më mirë.

Kryetari: Faleminderit, komandant! Besoj që, nëse automjetet parkohen gabim, janë detyra të policisë. Kur bllokohen trotuaret nga sektorët privatë, janë detyra të inspektoratit. Ne kemi kontratë për shënjim dhe janë duke punuar. Me sa di unë, në qendër aktualisht është i ndaluar parkingu i automjeteve dhe ka shenjë të ndalimit. Përkundër kësaj, asnjëherë nuk thashë që njerëzit nuk duhet t'i kryejnë nevojat e tyre 2-3 minuta. Makinat po e bëjnë natën në qendër, pra nuk ka shenjë të parkingut, por ka shenjë që ndalohet parkingu. Besoj që një aksion i përbashkët (jondëshkues), por për ta zbutur këtë gjendje, polici – inspektorat është i nevojshëm. Sa i përket bagerave, komandanti ndoshta nuk e di, por është pronë private ajo. Por, përkundër kësaj, edhe nëse është pronë private, nuk është e drejtë që pjesët e makinerisë t'ëndë t'ua tregoni të gjithëve në një pjesë ku është pjesë urbane. E ftoj inspektoratin të tentojë ta zbusë gjendjen në të gjitha rrugët kryesore në qytet, sepse kemi nevojë për veprime më efikase dhe jo vetëm ndëshkuese.

3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrrezikshme:

Fazli Morina: Faleminderit, kryetar! Përveç aktivitetave në shkolla, ka pasur edhe aktivitete lidhur me kultin fetar. 822 patrullime kanë qenë vetëm rreth objekteve të kultit fetar, 16 vizita dhe kontakte me prijës fetarë dhe 29 pika kontrolli afér objekteve fetare. Në Zoqisht dhe në Hoçë të Madhe kanë qenë 147 vizitorë nga Kosova dhe nga viset e ndryshme. Të gjitha kanë kaluar mirë dhe pa ndonjë ekses. Në shkolla, edhe gjatë kësaj periudhe ka qenë situatë e qetë dhe stabile. Kanë qenë dy raste, keqtrajtim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare – lëndim i lehtë trupor dhe sulm nga qentë endacakë. Zyrtarët policorë kanë vazhduar me mbajtjen e ligjëratave me tema të ndryshme: Pasojat e përdorimit të narkotikëve, ruajtja e ambientit dhe e trashëgimisë kulturore, bullizmi dhe masat parandaluese dhe siguria e qarkullimit këmbësor në trafik. Janë realizuar 45 kontakte dhe vizita në shkolla, 244 patrullime dhe 26 pika kontrolli.

Avni Morina: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë! Gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar me koordinimin DKA - stacion policor, rrëth ligjëratave vetëdijesuese që po mbahen nëpër shkolla. Temat e trajtuar janë në përputhje me planin operativ që e kanë hartuar zyrtarët policorë.

Kryetari: Sa e kuptova unë, ka pasur një incident në shkollën "Sadedin Hajda", a keni marrë ndonjë masë administrative?

Avni Morina: Ne kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm edhe me policinë për rastin që ka ndodhur në shkollën "Sadedin Hajda", keqtrajtim i fëmijëve nga një mësimdhënëse. Janë marrë të gjitha masat, lënda është proceduar në prokurori. Si DKA, në përputhje me ligjin dhe në konsultim me Zyrën Ligjore do të veprojmë për rastin në fjalë.

Enis Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Dëshiroj të potencojo që dje e prezantova në shkollë, te ato irrethojat që i kemi bërë në kuadër të KLSP-së dhe që është projekt i financuar nga OSBE-ja, në shkollën "Gëzim Hamza", si dhe janë disa kërkesa të vazhdueshme në atë zonë rrëth ndriçimit publik të disa rrugicave të lagjeve. Mungesa e ndriçimit rrit rrezikun nga qentë endacakë.

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryetar! Në disa pjesë të Lagjes së Epërme në Rahovec, ka drita që nuk janë vendosur ende kabllo. Janë drita digitale që kemi bërë zgjerime dhe javën e ardhshme kompania rikthehet në punë.

Ylvi Shehu: Përshëndetje! Meqë po flasim për drita, ka tre muaj që e kam cekur që prej xhamisë të "Kasumit" (rruga poshtë), prej rrugës "Kuvendi i Lezhës" deri te "Gërdina" dhe prej udhëkryqit deri te "Sokoli", ka tre muaj që nuk punojnë 4 drita. Tani është edhe më shqetësuese, sepse është taravia dhe njerëzit, burrat dhe gratë, qarkullojnë më shumë në këtë rrugë për të shkuar në xhami. Doja t'i ndihmoja pak komandantit. Te populli ynë masa më e mirë është dënim. Pse parkingjet në Prizren nuk kanë probleme?... Vetëdijesim po, por gati qe 25 vjet jemi duke bërë vetëdijesim. Veprim dhe jo vetëdijesim. Prej stacionit të autobusëve e parkon veturën në qendër dhe vazhdon duke e pirë kafenë, ky nuk është vetëdijesim! Diçka tjetër, dita e premte është ditë e katastrofës dhe fatmirësisht që nuk ndodh ndonjë zjarr. Prej teqesë tonë vijnë njerëzit dhe grumbullohen me vutura, xhamia në qendër po, xhamia Kadiri, teqeja e Sheh Mejdisë, po? Pse?... a jemi duke u falur për vete, a për popull? Normal që për vete. D.m.th, të ecim në këmbë dhe mos të krijojmë tollovi, sepse falja është individuale, ndërsa pengesa është kolektive.

Kryetari: Atëherë, Përparim, përderisa të përfundojë mbledhja, sa u përket atyre 4 dritave, shko thirri kujdestarët dhe le të shkojnë për t'i rregulluar menjëherë.

Sabahudin Durguti: Përshëndetje, kryetar! Meqë është fjala për ndriçim të rrugëve, ka një javë, apo 10 ditë që në rrugën "Gani Mullabazi" nuk ndizen dritat fare gjatë natës.

Kryetari: Përparim, nuk kam dëshirë që t'i dëgjoj në KKSB këto shqetësimë, sepse ne kemi një kujdestari për këto punë.

Fazli Morina: Faleminderit, baca Ylvi! Pajtohem me ju, por jo me atë që the për Prizrenin, sepse banor i Prizrenit jam vetë. Në Prizren, pavarësisht që ka parkingje shumë, është tmerr me kaos në komunikacion. Në krahasim me Prizrenin, gjendja këtu në Rahovec është shumë e mirë dhe plotësisht pajtohem që ne, veç shqiptimi i masës na kthen në dinjitet.

Kryetari: Sa i përket ndriçimit, nuk e besoj që është ndonjë komunë e Kosovës me ndriçim më shumë se sa komuna e Rahovëcit. Kur operatorët e tjerë si Vala e Ipko intervenojnë në punët e tyre, atëherë mund të na shfaqen edhe defekte të ndryshme në ndriçim. Investimi në ndriçim publik si element thelbësor i sigurisë së përgjithshme do të vazhdojë në zgjerim dhe në mbikëqyrje.

4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndëretnik, multikulturor dhe ndërfetar:

Kryetari: Ne kemi një zyrë komunale për komunitete me shef Lendritin, e kemi Komitetin për Komunitete, që është organ obligativ i Kuvendit të Komunës, si dhe plot veprime që jemi duke i zhvilluar, të cilat në instancë të fundit kanë për qëllim të krijojnë pasqyrë që qytetarët trajtohen njësoj, pa dallim se ku jeton dhe çfarë përkatësie etnike ka. Gjithashtu, edhe në aspektin e investimeve ka trajtim të barabartë. Fusha e sportit që e përruruam dje në Shkollën “Gëzim Hamza” është vepër e ZKKK-së. Punojmë me këtë koncept, duke planifikuar shumë aktivitete të tjera kulturore me mbështetje nga OSBE-ja, KFOR-i dhe e mira e kësaj është që nuk kemi probleme fetare, ndërkulturore apo ndëretnike.

Egzon Hamza: Përshëndetje për të gjithë! Më datë 2 shkurt, kam parashtruar ankesë në lidhje me ndriçimin për rrugën “Lazar Kojunqiq”, por nuk kam marrë përgjigje, edhe pse u informova pak për këtë proces. E dyta, më 5 mars, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa kam dërguar një ankesë në lidhje me shqetësimin e banorëve sa i përket shpejtësisë së madhe të automjeteve. Banorët kanë kërkuar që në rrugë të vendosen disa pengesa. Kësaj radhe shpresojmë që kjo ankesë e jona të merret me seriozitet nga ana juaj.

Kryetari: Faleminderit, Egzon! Besoj që për ndriçim i more disa përgjigje. Aty ku kemi mundësi do të intervenojmë shumë shpejt. Sa u përket pengesave në rrugë, në javën tjetër duhet ta pranosh një përgjigje nga drejtori Afrim Limani.

5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat:

Kryetari: Kjo është pikë standarde dhe ditëve të fundit e keni parë punën kolosale në largimin e deponive ilegale. Besoj që e keni vërejtur që paradite e kemi pastruar një deponi, kurse pasdite kanë hedhur përsëri mbeturina në të njëtin vend. Unë nuk dua të flas si komandanti, sepse ky është me uniformë. E shfrytëzoj rastin që t'ju them që ai që hedh mbeturina do të dënohet deri në 2000€ gjobë. Ju ftoj që të gjithë ju dhe ne së bashku t'i raportojmë rastet në inspektorat. Te “Rrezet” e Krushës është rrafshnaltë, kodër e butë dhe ndodh që edhe aty hedhin mbeturina, e kemi pastruar edhe aty. Pikërisht duhet që njerëzit të kenë pak turp të hedhin mbeturina afër varrezave, njerëzit e kanë dhënë jetën dhe nuk shkon që afër varrit të kenë mbeturina, apo në një vend të gjelbëruar. Ndërkaq, nëse e kemi qytetin e pastër, komuna fiton grante nga Evropa, Amerika, USAID-i dhe qeveria. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin, lidhet me këtë temë, sepse njerëzit e pandërgjegjshëm hedhin mbeturina edhe nëpër përrenj, në Dri të Bardhë, si dhe në kanalizime të ujërave të zeza.

6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:

Kryetari: ne nuk kemi numër të madh të inspektorëve, përkundër kësaj, inspektorët janë aktivë. Një pjesë e inspektorëve i ka centralizuar qeveria. Inspektorin sanitari, inspektorin e punës, inspektorin e tregut, sektorin e pyjeve, te këta asnë fije kompetence nuk e kemi si komunë. Te kontrolli i produkteve ushqimore, konsumatori mund t'i telefonojë disa numra për kontrolle ushqimore, për të qenë sa më të sigurt në ushqimet tona. Përndryshe, inspektorati ynë shqipton gjoba për produktet në afat të skaduar.

Erseka Cana: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Si qytetare e Rahovecit dhe si anëtare e KKSB-së po e ngrë një çështje. Sot është dita ndërkombëtare e konsumatorit, ku ne i paguajmë qeset. E qartë dhe e mirëpritur nga konsumatorët, mirëpo ne po e paguajmë edhe logon reklamuese. Personalisht më ka ndodhur së paku tri herë (SuperViva). Në bazë të udhëzimit administrativ për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit, ndalohet vendosja e logos apo e markës tregtare dhe nëse qeset e plastikës shiten me logo, i bie të punohet kundër vendimit të qeverisë. Lus drejtorinë përkatëse të ndërmarrë masa.

Kryetari: Ky udhëzim administrativ ka dalë së voni, nuk është i hershëm dhe rregullorja të cilën ne e kemi në dispozicion nuk i ka paraparë rastet e tillë. Mendoj që duhet të ankohemi te ai numri në të cilin thirrja është falas. Ky është një apel për të gjithë ata, këtë muaj të jeni sa më njerëzorë dhe atyre që agjerojnë ju dëshiroj agjërim të lehtë.

7. Të ndryshme:

Ylvi Shehu: E kam një shqetësim si qytetar. Shtëpinë ku e ka ndërtuar lart te "Bllato" Halil Kastrati, atë rrugë ju e keni mbushur me zhavorr. Mendoj që përmes Kuvendit e keni bërë rregullimin e rrugës në fjalë. Deri tani ka qenë rrugë e fushës, e tani është rrugë e truallit. Atij personi që po i kalon rruga në arën e tij, mbrëmë, personi në fjalë, me bager e ka bërë ndërprerjen e rrugës afér 1 m dhe rruga ka dalë në arën e tij. Në atë zonë janë rreth 100 vetë. Një angazhim i juaji kadastral duhet të bëhet rreth verifikimit të kësaj parcele.

Kryetari: Faleminderit, baca Ylvi! Berati, Përparimi dhe Afrim Oruqi, nesër do të takohen me ty dhe ia tregon vendin e parcelës.

Ylvi Shehu: Faleminderit! Personi në fjalë është një djali që nuk është i matur, mbiemrin e ka Durguti dhe ai e ka bërë kufizimin e arës së tij, njëkohësisht e tërë rruga ka dalë në anën e arës së tij. Këtu duhet të bëhet zgjidhje e përhershme.

Shaip Shala: Faleminderit! Në mënyrë vetëkritike, dëshiroj të diskutoj rreth pikës nr 6. Jam vetëkritik, sepse në këto vite, 74 falë zotit, asnjëherë nuk i kam shikuar produktet a kanë afat, apo jo. Deri sot mirë që nuk kam pasur pasoja, prej sot si anëtar i KKSB-së do të shkoj në "Planet", prodhimet që i blej do t'i shikoj afatet dhe nëse ka me afat të skaduar do t'i fotografoj për t'i lajmëruar inspektoratin.

Kryetari: Faleminderit, Shaip! Latinët kanë thënë që "nuk është më së miri ta lexosh veç një libër", ti mos shko vetëm te "Planeti", shko edhe te të tjerët dhe raporto te numri i konsumatorit.

Lulzim Krasniqi: Kryetar, më intereson se çka është duke ndodhur me kërkesën për "Shoqatën e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara", sa i përket ambientit administrativ punues?

Kryetari: Faleminderit! Kjo temë nuk është hiç në rend dite. Do ta shqyrtojmë këtë kërkesë dhe jemi duke shikuar t'ju bëjmë një zgjidhje, përndryshe veç a mund t'i zhvilloni veprimitaritë.

Lulzim Krasniqi: Kryetar, më fal, por që 23 vjet në atë objekt vetëm 10% shfrytëzohet.

Kryetari: Ajo nuk është detyrë e juaja, është detyrë e Kuvendit të Komunës. Nuk kam qenë unë, kur Asambleja Komunale ia ka dhënë objektin Kryqit të Kuq, Hendikosit dhe Nënë Terezës. Më mire është të flasësh për të gjitha OJQ-të në përgjithësi, se sa vetëm për OJQ-në që e udhëheq ti. Ai objekt do të ristrukturohet i téri, 360.000€ i ka ndarë Ministria e Shëndetësisë për riorganizimin e objektit.

Lulzim Krasniqi: Sa për njoftim, "Nënë Tereza", në komunat: Rahovec, Malishevë, Suharekë dhe Viti, nuk ekziston si më, ekziston vetëm nëpër rajone.

Kryetari: Jo, Lul, nuk është e vërtetë! Por edhe ti tash ia ke nisur, së fundi e ke marr një grant prej UNDP-së, sepse aktivitetin e keni pasur të ndërprerë. Shpresoj që fondin e fituar do ta shpenzosh drejt, sepse ka kontolle ndaj OJQ-ve. Mos e shfrytëzo foltoren për temat të cilat lidhen për interesin tënd individual. Faleminderit shumë, shihemi në mbledhjen e radhës!

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi

